

BREAKING NEWS

x

SHKERMOCET LSI, SHKRIHEN 5 DEGE NE TIRANE DHE DISA TE TJERA NE RRETHE, PS I ...

AKTUALITET

Ngjarje e rëndë, qëllohet me breshëri plumbash kryeplaku i fshatit, shkon me urgjencë drejt Tiranës (Zbardhet emri)

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
13 PRILL 2019

Facebook


WhatsApp

Twitter

Email




Zbardhet ngjarja e ndodhur në fshatin Gribë të Gramshit, ku një shtetas u plagos me armë zjarri në këmbë, jashtë rrezikut për jetën. Policia ben me dije se ka identifikuar dhe shpallur ne kerkim autorin e dyshuar, shtetasin me inicialet S.V.



“Ky shtetas mbrëmjen e djeshme në fshatin Gribë, Gramsh , për motive të dobëta dyshohet se ka plagosur me armë zjarri shtetasin T.V., 54 vjeç dhe është larguar, ku forcat e Policisë po punojnë për kapjen e tij si dhe për gjetjen e sekuestrimin e armës së zjarrit”- njofton policia.

Njoftimi i policise



Identifikohet dhe shpallet në kërkim autori.

Si rezultat i veprimeve të shpejta dhe profesionale të kryera nga Specialistët për Hetimin e Krimit në Komisariatit e Policisë Gramsh, në bashkëpunim me Specialistët e Hetimit të Krimit ndaj Personit, në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, u bë e mundur identifikimi dhe shpallja në kërkim e autorit të dyshuar S.V, ku vijon puna për kapjen e tij.